REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:206037
Datë: 18.10.2022
Numri i dokumentit: 03542164

CML.nr.6/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Muhamet Rexha, kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit L. T. nga fshati ..., Komuna K., të cilin me autorizim e përfaqëson Flamur Troni, avokat nga K., kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilën e përfaqëson Ministria e Drëejtësisë – Avokatura Shtetërore, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, Kmlc.nr.31/22, datë 24.05.2022, të paraqitur kundër aktvendimit Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10256/21, datë 24.03.2022, në seancën e mbajtur më 04.10.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet kërkesa e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë, ndryshohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.10256/21, i datës 24.03.2022, ashtu që mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik PPP.nr.39/21, i datës 25.11.2021.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega Kaçanik, me aktvendimin PPP.nr.39/21, të datës 25.11.2021, në pikën I të dispozivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, Qeveria

2022:111988

e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i ushtruar më datë 26.04.2021 kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.263/2021, i datës 15.04.2021, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Sh. L. nga F., ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet debitori që të bëjë ekzekutimin e propozimit përmbarimor si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.10256/21 të datës 24.03.2022 ka aprovuar si të themeltë ankesën e përfaqësuesit ligjor, debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe ka ndryshuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, PPP.nr.39/21, të datës 25.11.2021, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: Pranohet i bazuar prapësimi i përfaqësuesit ligjor të debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Shfuqizohet (vihet jashtë fuqie), urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.263/2021, i datës 15.04.2021, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore, ndërsa propozimi për përmbarim i kreditorit L. T., refuzohet i pabazuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të aplikimit të gabueshëm të drejtës materiale nga neni 247 paragrafi1 pika (b) lidhur me nenin 184 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajshtme Nr.03/L-139, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ashtu që të prishet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10256/21 i datës 24.03.2022, dhe lënda t'i kthehet gjykatës së njëjtë në rivendosje.

Për të vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata Supreme ka caktuar seancë me datë 04.10.2022, në të cilën edhe pse janë ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dhe debitori, ndërsa ka marrë pjesë Flamur Troni, avokat i autorizuar i kreditorit. Në këtë seancë i autorizuari i kreditorit ka mbështetur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke vlerësuar se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i paligjshëm ndërsa ka mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me pretendim se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi përmban të gjitha elementet e përcaktuara me ligj që e bëjnë vendimin e përshtatshëm për përmbarim. Ka theksuar se ndërkohë debitori ka përmbushë obligimin që ka dalë nga titulli përmbarues, ndërsa interesi i kreditorit është që të aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendimi i marrë nga Qeveria e Kosovës të trajtohet si titull përmbarues.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 251 lidhur me nenin 230 të LPK-së ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori L. T. nga fshati ..., Komuna K., me datë 15.04.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim, ndaj debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të Vendimit nr.07/93, i datës 12.03.2019, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 6,025.00 euro. Përmbaruesi Privat duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me urdhrin përmbarimor P.nr.263/2021, të datës 15.04.2021, duke vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet si vendim përmbarues.

Debitori më datë 21.04.2021 ka paraqitur prapësim, duke theksuar se vendimi i nxjerrë nga kryeministri nuk paraqet dokument përmbarues në kuptim të nenit 22 të LPP-së, e po ashtu në mes të kreditorit dhe debitorit nuk ka pasur kontratë të lidhur, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore. Përgjigje në prapësim me datë 28.04.2021 ka ushtruar i autorizuari i kreditorit, duke theksuar se i kundërshton të gjitha pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin e përmbaruesit privat ta lejë në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë duke trajtuar prapësimin e debitorit ka theksuar se prapësimi nuk i plotëson asnjërën nga kushtet ligjore nga neni 71 të LPP-së, e po ashtu urdhri i përmbaruesit privat është i ligjshëm dhe i rregullt dhe nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të Vendimit Nr.07/93, të datës 12.03.2019, i cili paraqet dokument përmbarues në kuptim të dispozitës së nenit 22 paragrafi 1.2 e lidhur me nenin 23.2 e lidhur me nenin 24 paragrafi 3 të LPP-së.
Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesës së debitorit kundër vendimit të shkallës së parë, ka vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar ngase gabimisht kanë aplikuar dispozitën e nenit 22 paragrafi 1.2 e lidhur me nenin 23.2 dhe me nenin 24 paragrafi 3, nenin 71 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorëve i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë

dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë atë se çka konsiderohet dokument i përshtatshëm për përmbarim dhe mbi cilën bazë mund të iniciohet procedura e përmbarimit. Me shikimin e shkresave të lëndës konstatohet se në këtë rast gjykata e ka lejuar përmbarimin dhe e ka cilësuar si titull përmbarues Vendimin nr..., të datës 12.03.2019, vendim i lëshuar nga kryeministri në procedurë administrative, mirëpo Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi i tillë nuk mund të konsiderohet titull përmbarues ngase në dispozitiv nuk e përmban shumën e detyrimit, nuk përmban periudhën kohore dhe nuk përmban afatin brenda të cilit duhet të përmbushet detyrimi, ashtu siç është përcaktuar me dispozitën ligjore të sipërcituar.

Gjykata e Apelit më tej ka theksuar se titulli përmbarues është ai mbi bazën e të cilit iniciohet procedura e përmbarimit dhe realizohet kërkesa e përmbajtur në të, duke vlerësuar se në rrethana të tilla nuk ka pasur kushte ligjore të iniciohet procedura e përmbarimit dhe të lejohet përmbarimi nga gjykata e shkallës së parë, kjo pasi që vendimi administrativ në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore nuk është i përshtatshëm për përmbarim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 27 të LPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së dytë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate përfundimi në këtë çështje është në kundërshtim me të drejtën materiale, përkatësisht dispozitat nga nenet 22 dhe 27 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë për të pranuar prapësimin e debitorit, shfuqizimin e urdhrit përmbarimor dhe refuzimin e propozimit për përmbarim, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë atë se çka konsiderohet dokument i përshtatshëm për përmbarim dhe mbi cilën bazë mund të iniciohet procedura e përmbarimit.

Me nenin 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 është përcaktuar se dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbaj element e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Me dispozitën ligjore të nenit 27 të LPP-së, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit"*. Në këtë rast përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe ka cilësuar si titull përmbarues vendimin nr..., të datës 12.03.2019, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se vendimi i tillë është i përshtatshëm për përmbarim. Përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në tërsi e mbështet Gjykata Supreme duke vlerësuar se vendimi i përdorur si titull përmbarues i plotëson në mënyrë komulative kushtet e

përcaktuara në nenin e sipërcituar, ngase në pikën II të dispozitivit qartë është përcaktuar se pjesë integrale e vendimit është shuma që është vlerësuar nga organi i shpronësimit, pra dihet cila është shuma, pastaj është paraqitur periudha kohore dhe afati brenda të cilit duhet të përmbushet detyrimi.

Nga këto arsye, Gjykata Supreme vlerëson ndryshe zbatimin e të drejtës materiale nga Gjykata e Apelit dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të pranohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe të mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik PPP.nr.39/21, i datës 25.11.2021

Në bazë të asaj që u tha, e me zbatimin e nenit 251 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
CML.nr.6/2022, datë 04.10.2022

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Muhamet Rexha